



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 1029/1 Prad.

VENDIM
Nr. 121, datë 27.04.2021

Tiranë, më 04.05.2021

**PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE PËR
POZICIONIT VAKANT NR. 1 NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË
APELIT TIRANË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 330, DATË 29.12.2020 TË
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 66 të Ligjit nr. 44/2015, të Kodit të Procedurës Administrative, në nenin 44 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” miratuar me Vendimin nr.261, datë 17.11.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Pezullimin e procedurës në lidhje me lëvizjen paralele për pozicionin vakant nr. 1, shpallur me Vendimin nr.330, datë 29.12.2020 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të ankimit në gjykatë.
2. Të njoftohen për këtë vendim kandidatët e listuar në renditjen e Vendimit të Këshillit Nr. 93 datë 31.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR
MOISI DUDA**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

